



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1975/prot.

Pogradec, më 10. 052021

VENDIM

NR. 40, DATË 06. 05.2021

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË
POGRADEC, TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË DO TË
PËRDOREN PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ FUNKSIONALE NË FUSHËN E
INFRASTRUKTURËS DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, vendimit nr. 500, datë 14.8.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e infrastrukturës, planifikimit të territorit dhe zhvillimit ekonomik, sipas formularëve bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve.
3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT
Sotiraq MANGËRI

